



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 1687/Prot

Shkodër, më 30 09.2026

Lënda : Publikim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

### AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

(Adresa : Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" - Këshilli i Ministrave)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës për dy vende të lira pune.

Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI

Prof. dr. Tomi Gjiraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

R E K T O R I

Nr. 1687 Prot

Shkodër, më 30 . 04 .2026

### N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për dy vende të lira pune, për kategorinë staf ndihmës-akademik me karakter administrativ pranë Bibliotekës Shkencore, pozicioni "Bibliotekar/e në fondin e librit në gjuhë të huaj" dhe pozicioni "Restaurator/e".

#### **Kandidatët për bibliotekar/e duhet të plotësojnë këto kritere specifike :**

1. Të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën e shkencave shoqërore ose në gjuhën angleze, në sistemin me kohë të plotë (Bachelor dhe Master i Shkencave, Program studimi i integruar i ciklit të dytë, Program i nivelit të dytë ose Program studimi 4-vjeçar). Kriteri minimal i diplomës për efekt kandidimi në këtë pozicion është "Master profesional". Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse për arsimin, e noterizuar.
2. Nota mesatare e përgjithshme në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve duhet të jetë jo më e ulët se 7 (shtatë).
3. Të jenë njohës shumë të mirë të gjuhës angleze, me nivel jo më të ulët se C1 (notë jo më të ulët se nëntë) të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
4. Preferohet që kandidatët të kenë :
  - 4/1. kryer specializime apo kualifikime në fushën përkatëse ku konkuron,
  - 4/2. aftësi shumë të mira komunikimi,
  - 4/3. përvojë pune të ngjashme,
  - 4/4. përvojë pune në administratën publike,
  - 4/4. aftësi të mira kompjuterike.

#### **Kandidatët për restaurator/e duhet të plotësojnë këto kritere specifike :**

1. Të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën e shkencave shoqërore, në sistemin me kohë të plotë (Bachelor dhe Master i Shkencave, Program studimi i integruar i ciklit të dytë, Program i nivelit të dytë ose Program studimi 4-vjeçar). Kriteri minimal i diplomës për efekt

më e ulët se 7 (shtatë).

kandidimi në këtë pozicion është “Master profesional”. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse për arsimin, e noterizuar.

2. Nota mesatare e përgjithshme në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve duhet të jetë jo më e ulët se 7 (shtatë).

3. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, me nivel jo më të ulët se B1 (notë jo më të ulët se shtatë) të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.

4. Preferohet që kandidatët të kenë :

4/1. kryer specializime apo kualifikime në fushën përkatëse ku konkurron,

4/2. aftësi shumë të mira komunikimi,

4/3. përvojë pune të ngjashme,

4/4. përvojë pune në administratën publike,

4/4. aftësi të mira kompjuterike.

**Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :**

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.

2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.

3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.

4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.

5. Të mos jenë larguar nga USH “L.Gurakuqi” pa miratimin e këtij të fundit.

6. Të mos jetë marrë më parë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

7. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH “L.Gurakuqi”.

8. Të mos kenë lidhje **familjare** (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), **gjinie** (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës ekzistues brenda të njëjtes njësi bazë ku kërkojnë të punësohen, si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave, sipas ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :**

1. Të aplikojnë “on-line” në faqen zyrtare të USH-së në internet në adresen [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al) (rubrika Njoftime për punësim – staf joakademik).

2. Kërkesë me shkrim për punësim në USH,

3. Jetëshkrim (CV) me foto personale.

4. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse.
5. Kopje e noterizuar e dëshmimeve të kualifikimeve të ndryshme pasuniversitare.
6. Rekomandim ose letër referencë nga punëdhënësi i fundit.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose kopje e noterizuar.
8. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penaliteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbartimit).
9. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë).
10. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon (kopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
11. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të Rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore dhe/ose konflikt interesi).
12. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
13. Vërtetim rajoni për adresen/rezidencën e banimit (kontratë qiramarrje).

**Shënim :**

- Kontrata e punës do të jetë me afat të pacaktuar konform nenit 37 të Rregullores.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik. (me shënimin "Për konkursin e Bibliotekës Shkencore")
- Konkursi do të zhvillohet me dosje dhe intervistë brenda katër javëve nga publikimi i njoftimit.
- Legjislacioni rreth të cilit do të zhvillohet faza e dytë e konkurimit për të dy pozicionet (intervista me gojë) do të bazohet në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar, Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë", Ligji nr. 8576, datë 03.02.2000 "Për bibliotekat në RSH" i ndryshuar, Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" i miratuar me Urdhërin e MAS nr. 366, datë 05.07.2018.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Ankimimet mund të bëhen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e rezultatit.

**REKTORI**  
  
**Prof. dr. Tonin GJURAJ**